



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR ENERGJI DHE KLIMË”.

Konsultim publik : I hapur

Data : 09.05.2024

Ora : 13:00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Numri i pjesëmarrësve 22, nga të cilat 9 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : “Për miratimin e planit vendor të veprimit për energji dhe klimë”

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër, grupe interesi dhe qytetarë. (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Prezantimi i këtij plani bëhet nga prof. Besim Islami, specialist i fushës. Ai shpjegon në detaje planin për klimë dhe energji.

Pas prezantimit të bërë nga **Prof. Islami, Z. Luli** kërkon të dijë më tepër në lidhje me nivelin e emetimit të gazrave të transportit në natyrë. Si ka mundësi, që niveli i gazrave është i lartë, në një kohë që qyteti i Shkodrës nuk ka fabrika, që rrisin nivelin e gazrave të dëmshme në natyrë?

Përgjigjet **Z.Islami**, duke ju referuar edhe planit të paraqitur.

Z.Luli, fton të pranishmit për pyetje dhe diskutime mbi temën e takimit.

Fjalën e merr **Z.Viktor Sheldija**, i cili pyet në lidhje me kaldajat në shkolla. Ai shprehet se Gazi është alternativë e mirë por ka rrezikshmëri, paleta ka problem me cilësinë e saj pasi nuk mund të kontrollohet asnjëherë saktë kur blihet.

Përgjigjet përsëri **Z.Islami** duke thënë se sipas mendimit të tij dhe disa studimeve të kryera, alternative më e mirë për ngrohjen në shkolla është kaldaja më karburant, pasi siguron ngrohje maksimale për kohë më të gjatë, por ka kosto të lartë. Prandaj duhet të tregohemi kursimtar, duke zgjedhur si alternative paletin, por duhet bërë blerje e zgjuar, paleti duhet blerë një vit para mundësisht dhe të zgjidhet cilësia.

Z.Anamali, anëtar i Këshillit Bashkiak merr fjalën dhe në lidhje me emetimin e gazrave ai shprehet se më sipër u tha se një nga masat për uljen e emetimeve është përdorimi i transportit publik. Por realiteti është krejt ndryshe. Ne kemi shumë shqetësime, ankesa p.sh nga banorët e Zogajve, pasi nuk respektohen kontratat dhe oraret e operatorëve të transportit dhe dashje pa dashje qytetarët ndjehen të detyruar të përdorin transportin privat.

Përsëri përgjigjet **Z.Islami**, duke thënë se zgjidhja në këtë rast është disiplinimi i qarkullimit. Por duhet deomos të rregullohet oraret, tarifat dhe shërbimi. Dhe kjo do paraqitet edhe në planin e mobilitetit.

Z.Lesha merr fjalën dhe thotë se ky takim konsultativ i paraprin vendimmarrjes së këtij plani në Këshill. Ai kërkon të dijë cili do jetë ndikimi i tij në buxhetin e Bashkisë, a mendoni se duhet të rishikohet buxheti i këtij viti, në përputhje me objektivat e planit apo mbetet për buxhetin e viteve të ardhshme, pasi tashmë planifikimet janë kryer.

Përgjigjet **Znj.Shllaku**, e cila shprehet se plani në fjalë është një strategji e Bashkisë Shkodër për 10 vitet e ardhshme dhe nuk ndikon drejtëpërdrejtë në buxhetin e këtij viti. Por sigurisht që në vazhdim ky plan do ketë patjetër ndikimin e tij në buxhet.

Z.Luli falenderon edhe njëherë **Z.Islami** dhe grupin e punës që përgatitën planin e veprimit për energji dhe klimë.

Pyetje dhe diskutime nuk ka. Takimi konsultativ deklarohet i mbyllur.

KRYETAR

Oltion LULI

Zbardhi procesverbalin:

Irma Sulishti

TAKIMI KONSULTATIV MBI PRAVENDIMIN: "PER MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TW VEPRIMIT PER ENERGI DHE KLIME"

Liste prezence

Nr.	Emer Mbiemer	Fshati/Qyteti	Kontakt	e-mail	Firma
1.	Yehorzen	Shkoder			
2.	Samed Bushati	Shkoder			
3.	Arda Qetaj	Shkoder			
4.	Harisida Telilija	Shkoder			
5.	Merudaj Nikunj	Shkoder		Saudakling@gmail.com	
6.	Sauda Selaj	Shkoder		crime team@yahoo.com	
7.	Yrma Lemeli	Shkoder		Weslanaaketh@yahoo.com	
8.	Arben Gjoka	Shkoder			
9.	Arben Gjoka	Shkoder			
10.	Kediana Hallimaj	Shkoder			
11.	Yskoum Progid	Shkoder	0696411334	erkoubaric@gmail.com	
12.	Viktor Sheldaj	Shkoder	0692458711	Viktor.Sheldaj@gmail.com	
13.	Portel Folezi	Burim Guri	0695580000	meding@gmail.com	
14.	Gjergj Nikit	SHKODER	0697772126	meding@gmail.com	
15.	Danion Bozaj	SHKODER			

